



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 30 qershor 2022
Nr. Ref.:RK 2018/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. K107/22

Parashtrues

Miljan Koshanin

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit Pml. nr. 474/2021 të 28 dhjetorit 2021
të Gjykatës Supreme të Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Miljan Koshanin, nga fshati Gazivodë në Zubin Potok (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Petronije Božović, avokat në Zubin Potok.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [Pml. nr. 474/2021] e 28 dhjetorit 2021 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në lidhje me Aktvendimin [Kr. 1. nr. 1457/2021] e 14 dhjetorit 2021 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Divizioni në Mitrovicën e Veriut (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktvendimin [PIP. nr. 236/21] e 2 dhjetorit 2021 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Parashtruesi i kërkesës Vendimin e kontestuar e ka pranuar më 7 janar 2022.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkëlur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në ndërlidhje me nenin 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) dhe me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 12 janar 2022, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij përmes postës të cilën Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) e pranoi me 21 janar 2022.
7. Më 3 shkurt 2022, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [GJR. KIO7/22] caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Safet Hoxha (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
8. Më 24 shkurt 2022, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi të dorëzojë në Gjykatë formularin e plotësuar të kërkesës si dhe autorizimin për përfaqësim në Gjykatë. Në të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
9. Më 18 mars 2022, Gjykata sërish kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të dorëzojë në Gjykatë formularin e plotësuar të kërkesës si dhe autorizimin për përfaqësim.
10. Më 29 mars 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë formularin e plotësuar të kërkesës dhe autorizimin për përfaqësim në Gjykatë.
11. Më 8 qershor 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 4 nëntor 2021, Prokuroria Themelore në Mitrovicë (në tekstin e mëtejshëm: Prokuroria Themelore) përmes kërkesës [KT.I.nr. 1477/20] i kërkoi Gjykatës Themelore në Mitrovicë caktimin e masës së paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës, për shkak të dyshimit të bazuar se i njëjti, në cilësinë e pjesëtarit të Policisë së Kosovës, kishte kryer veprat penale “*Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar*” nga neni 414, paragrafi 2, “*Përvetësimi në detyrë*” nga neni 418, paragrafi 2 dhe “*Manipulimi me prova*” nga neni 389, paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPRK).
13. Më 5 nëntor 2021, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [PIP. nr. 236/21] caktoi masën e paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës në kohëzgjatje prej një (1) muaji.
14. Më 2 dhjetor 2021, Prokuroria Themelore përmes kërkesës [KT.I.nr.14777/2020] i kërkoi Gjykatës Themelore vazhdimin e masës së paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës.
15. Më 2 dhjetor 2021, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit [PIP. nr. 236/21], i vazhdoi paraburgimin parashtruesit të kërkesës në kohëzgjatje prej një (1) muaji, përkatësisht nga 4 dhjetori 2021 deri më 4 janar 2022. Vazhdimin e paraburgimit, Gjykata Themelore e arsyetoi se ishin plotësuar kushtet ligjore për caktimin e masës së paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës, pasi që ekzistonte (i) rreziku i arratisjes, (ii) rreziku i ndikimit në dëshmitarë, (iii) rreziku i përsëritjes së veprës penale, dhe (iv) rrjedhimisht masat tjera alternative ishin të pamjaftueshme për zhvillimin e suksesshëm të procedurës penale.
16. Në vijim, në arsyetimin e aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore u theksua se për vazhdimin e paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës ishin marrë parasysht: (i) pranimi i fajësisë nga ana e tij; (ii) dëshmitë e marrjes në pyetje të dëshmitarëve Z. M. dhe M. R. lidhur me nxjerrjen e sendeve prej dhomës së dëshmitarëve nga parashtruesi i kërkesës; si dhe (iii) largimi i tij në Bosnje dhe Hercegovinë, me qëllimin që të mos kthehej më në Kosovë.
17. Më 7 dhjetor 2021, parashtruesi i kërkesës kundër Aktvendimit [PIP. nr. 236/21] të Gjykatës Themelore paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit duke i propozuar kësaj të fundit që ta ndryshojë aktvendimin e ankimuar dhe që atij t’i shqiptojë masën e arrestit shtëpiak. Në ankesën e tij, parashtruesi i kërkesës theksoi se Gjykata Themelore gabimisht i ishte referuar paragrafit 1, nënparagrafëve 1.1 dhe 1.2, pikave 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të nenit 187 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPPRK) për vazhdimin e paraburgimit ndaj tij.
18. Më 10 dhjetor 2021, Prokuroria e Apelit e Kosovës, përmes shkresës [PAR/I. nr. 1442/2021] i propozoi Gjykatës së Apelit që ta refuzojë ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe kërkoi që të vërtetohet Aktvendimi [PIP. nr. 236/21] i 2 dhjetorit 2021, i Gjykatës Themelore.
19. Më 14 dhjetor 2021, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [Kr.1. nr. 1457/2021], e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës si dhe e vërtetoi Aktvendimin [PIP. nr. 236/21] e Gjykatës Themelore, për të cilin konstatoi se nuk ishte i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës penale dhe të së drejtës materiale dhe se masa e paraburgimit

përkonte me peshën e veprave penale në fjalë, për të cilat ekzistonte dyshimi i bazuar se parashtruesi i kërkesës i kishte kryer.

20. Në arsyetimin e aktvendimit të lartcekur, Gjykata e Apelit vlerësoi se Gjykata Themelore në mënyrë të drejtë kishte zbatuar paragrafin 1, nënparagrafët 1.1 dhe 1.2, pika 1.2.2 të nenit 187 të KPPRK-së, sepse ekzistonte rreziku i ndikimit nga parashtruesi i kërkesës në dëshmitarët Z. M. dhe M. R., marrë parasysh faktin që ai kishte punuar me ta më herët dhe i njëjti do të kishte mundësi të pengonte procesin hetimor. Ndërkaq, për sa i përket plotësimit të kushteve ligjore nga paragrafi 1, nënparagrafët 1.1 dhe 1.2, pikat 1.2.1, 1.2.3 të nenit 187 të KPPRK-së, konkretisht rrezikut të arratisë dhe përsëritjes së veprës penale, Gjykata e Apelit vlerësoi se nuk ekzistonte një rrezik i tillë duke pasur në konsideratë se pas kthimit nga Bosnja dhe Hercegovina, parashtruesi i kërkesës ishte dorëzuar vullnetarisht tek organet kompetente dhe se ai më nuk ushtronte detyrat zyrtare me të cilat kishte qenë i ngarkuar në kohën kur ai dyshohej se kishte kryer veprat penale.
21. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës kundër Aktvendimit [Kr. 1. nr. 1457/2021] të Gjykatës së Apelit paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës penale, me pretendimin se dispozitivi i vendimit të Gjykatës së Apelit ishte në kundërshtim me arsyetimin. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës shtoi se: *“Në të vërtetë, në faqen “3”, në paragrafin e parë të aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Divizioni në Mitrovicë është thënë: Trupi gjyqësor i kësaj gjykate nuk e ka pranuar masën e vazhdimit të paraburgimit të gjyqtarit të procedurës paraprake, kundër të pandehurit Miljan Koshanin në bazë të bazave ligjore nga neni 187, paragrafi 1, nën-paragrafët 1.1 dhe 1.2, pikat 1.2.1 dhe 1.2.3 të KPPRK-së, për shkak se trupi gjyqësor është i mendimit se nuk ekziston rreziku i arratisë, marrë parasysh se i njëjti pas ardhjes nga Bosnja i është dorëzuar vullnetarisht organeve kompetente për zhvillimin e kësaj procedure penale, dhe gjithashtu është përjashtuar mundësia se ekziston rrezik për përsëritjen e veprave penale me të cilat ngarkohet i pandehuri, sepse ato ai i ka kryer si person zyrtar, prandaj me vetë këtë ai për më tutje nuk mund të kryen detyrat të cilat i ka kryer me rastin e kryerjes së veprimeve inkriminuese”.*
22. Më 28 dhjetor 2021, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 474/2021], e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës, duke konstatuar se aktvendimi i lartcekur nuk ishte i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës penale.
23. Përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës lidhur me kundërtëhëniet në mes të arsyetimit dhe dispozitivit të aktvendimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, Gjykata Supreme theksoi se pretendimi i tillë është i pabazuar sepse sipas Aktvendimit të Gjykatës së Apelit ankesa e parashtruesit të kërkesës ishte refuzuar si e pabazuar, duke iu vazhduar atij masa e paraburgimit në përputhje me paragrafin 1, nënparagrafët 1.1 dhe 1.2, pika 1.2.2 të nenit 187 të KPPRK-së, si rezultat i rrezikut të ndikimit në dëshmitarë. Sipas Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, arsyet dhe rrethanat për refuzim i përkisnin vetëm bazës ligjore nga paragrafi 1, nën-paragrafët 1.1 dhe 1.2, pikat 1.2.1 dhe 1.2.3 të nenit 187 të KPPRK-së, përkatësisht kriterëve që ndërlidhen me rrezikun e arratisë dhe përsëritjen e veprës penale.
24. Më 31 dhjetor 2021, Gjykata Themelore, bazuar në kërkesën e Prokurorisë Themelore, përmes Aktvendimit [PIP. nr. 236/21] i vazhdoi masën e paraburgimit parashtruesit të kërkesës në kohëzgjatje prej një (1) muaji, përkatësisht nga 4 janari 2022 deri më 4 shkurt 2022.

25. Më 6 janar 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesë për përcaktimin e ligjshmërisë së paraburgimit pranë Gjykatës Themelore, respektivisht për heqjen e masës së paraburgimit të shqiptuar me Aktvendimin [PIP. nr. 236/21] e Gjykatës Themelore të 2 dhjetorit 2021, si dhe kërkoi mbajtjen e seancës dëgjimore në këtë gjykatë.
26. Në po të njëjtën ditë, Gjykata Themelore, përmes Njoftimit e refuzoi kërkesën për heqje të masës së paraburgimit përkitazi me Aktvendimin [PIP. nr. 236/21] e Gjykatës Themelore të 2 dhjetorit 2021, me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës kundër vendimit të lartcekur kishte parashtruar së pari ankesë e cila ishte refuzuar si e pabazuar nga Gjykata e Apelit dhe më pas kishte parashtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, gjithashtu e refuzuar si e pabazuar. Përveç kësaj, përmes këtij njoftimi, Gjykata Themelore informoi parashtruesin e kërkesës se me Aktvendimin [PIP. nr. 236/21] e Gjykatës Themelore, të 31 dhjetorit 2021, parashtruesit të kërkesës i ishte vazhduar masa e paraburgimit dhe ky i fundit ndaj këtij vendimi kishte të drejtë të paraqiste parashtresa.
27. Në vijim, sa i përket kërkesës së parashtruesit të kërkesës për mbajtjen e seancës dëgjimore, Gjykata Themelore, duke iu referuar Mendimit juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës [S.U.565/13] të 19 shtatorit 2013, theksoi se: *“Kur parashtrohet kërkesa për vlerësimin e ligjshmërisë së paraburgimit (sipas nenit 192 të KPP-së), nuk është e domosdoshme të nxirret një vendim formal, përveç nëse vendoset që seanca dëgjimore të mbahet nën kushtet e përcaktuara me ligj. Në situata të tilla i pandehuri dhe mbrojtësi vetëm informohen me shkrim se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për shfuqizimin e masës së paraburgimit”*.
28. Më 7 janar 2022, parashtruesi i kërkesës kundër Aktvendimit [PIP. nr. 236/21] të Gjykatës Themelore të 31 dhjetorit 2021 paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës penale, me propozimin që të ndryshohet aktvendimi i ankimuar dhe atij t'i shqiptohet masa e arrestit shtëpiak.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

29. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se atij i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 5 të KEDNJ-së, si dhe me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
30. Parashtruesi i kërkesës thekson se paraqet kërkesë para Gjykatës për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale të përcaktuara me nenin 384, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 dhe paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 si dhe të nenit 370, paragrafi 6 të KPRK-së, pasi që dispozitivi dhe arsyetimi i vendimit të gjykatës së shkallës së dytë janë në kundërshtim me njëri-tjetrin.
31. Përkitazi me pretendimin për shkelje të së drejtës së lirisë dhe sigurisë të garantuar me nenin 29, paragrafi 1 i Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës thekson se *“[...] parashtron ankesë kushtetuese kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Divizioni në Mitrovicë Kr.1 nr.1457/2021 të datës 14.12.2021 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. 474/2021 të datës 28.12.2021, për arsye se me vendimet e lartpërmendura është shkelur dispozita e nenit 29, paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përkatësisht e Drejta e Lirisë dhe Sigurisë, që paraqet korpusin e të drejtave të njeriut, i cili është i mbrojtur me të gjitha dokumentet e përgjithshme për të drejtat e njeriut.*

Gjithashtu, neni 5 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka të bëjë me të drejtat për mbrojtjen e sigurisë fizike, e në veçanti me lirinë nga arrestimi apo paraburgimi arbitrar, duke siguruar garanci për të drejtat e caktuara themelore procedurale, si për shembull: e drejta e paraqitjes së personit të tillë para gjykatës pa vonesë. Liria e vërtetë është e rëndësishë qenësore për jetën e njeriut dhe ai mund të jetë vërtetë i lirë, vetëm nëse nuk i duhet të jetojë në frikë nga arrestimi arbitrar. Nga kjo rrjedh se në raport me pushtetin shtetëror dhe në veçanti me autoritetet policore dhe gjyqësore, liria personale është e barazuar me sigurinë”.

32. Tutje, për sa i përket shkeljes së të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës shton:

“Në rastin konkret me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë- Divizioni për Veprat e Rënda Penale PIP.nr.236/21 të datës 05.11.2021, të pandehurit Koshanin Miljan i është caktuar paraburgimi në kohëzgjatje prej një (1) muaji, duke llogaritur nga 04.11. deri më 04.12.2021, ndërsa me vendimin e datës 02.12.2021 të gjykatës së njëjtë masa e paraburgimit është vazhduar deri më 04.01.2022, dhe me vendimin e gjykatës së njëjtë të datës 31.12.2021, masa e paraburgimit është vazhduar gjithashtu në kohëzgjatje prej një muaji, përkatësisht deri më 04.02.2022.

Në ndërkohë nga ana e prokurorisë përkatësisht Gjykatës Themelore në Mitrovicë, i pandehuri përkatësisht mbrojtësi i tij nuk janë ftuar e as nuk janë informuar për paraqitjen apo mbledhjen e provave të reja”.

33. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata anulimin e Aktgjykimit [Pml. nr. 474/2021] të 28 dhjetorit 2021, të Gjykatës Supreme, si të paligjshëm dhe jokushtetues.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 29

[E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë]

“1. Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente, si në vijim:

(1) pas shpalljes së dënimit me burgim për kryerjen e veprës penale;

(2) për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një veprë tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjykimit në mënyrën e përcaktuar me ligj.

2. Çdokush që privohet nga liria, duhet të vihet në dijeni menjëherë, për arsyet e privimit, në gjuhën që ajo/ai e kupton. Njoftimi me shkrim mbi arsyet e privimit duhet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur. Çdokush që privohet nga liria pa urdhër të gjykatës, brenda dyzet e tetë (48) orësh duhet të dërgohet përpara gjyqtarit, i cili vendos për paraburgimin ose lirimin e tij/saj, jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë nga

momenti kur personi i privuar është sjellë para gjykatës. Çdokush që arrestohet, ka të drejtën që të nxirret në gjykim brenda një periudhe të arsyeshme, ose të lirohet në pritje të gjykimit, me përjashtim kur gjyqtari konstaton se personi përbën rrezik për komunitetin ose ka rrezik për ikjen e saj/tij para gjykimit.

[...]

4. Çdokush që i hiqet liria me arrest ose ndalim, gëzon të drejtën që të përdorë mjete juridike për të sfiduar ligjshmërinë e arrestit ose të ndalimit. Rasti do të vendoset nga gjykata brenda një afati sa më të shkurtër dhe nëse arresti ose ndalimi është i paligjshëm, do të urdhërohet lirimi i personit”.

[...]

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieeve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.

5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

6. Ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.

7. Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit.

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 5

(E drejta për liri dhe siguri)

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj:

[...]

c) kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent pas dyshimit të arsyeshëm se ka kryer një veprë penale ose kur çmohet në mënyrë të arsyeshme e nevojshme për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj;

[...]

3. Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1/c të këtij neni duhet të çohet menjëherë përpara një gjyqtari ose një zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohe brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në gjykim e sipër. Lirimi mund të kushtëzohet me dhënien e garancive për t'u paraqitur në procesin gjyqësor.

4. Çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm”.

[...]

KODI NR. 06/L-074 PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 389 Manipulimi me prova

1. Kushdo që ndryshon, heq, fsheh, shkatërron, dëmton ose e bën të pashfrytëzueshëm, tërësisht ose pjesërisht, ndonjë regjistër, pasuri, send ose dokument me qëllim të pamundësimit të shfrytëzimit të sendit në procedurë zyrtare, dënohet me gjobë ose me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
2. Kushdo që me qëllim të parandalimit ose vështirësimit të mbledhjes së provave në procedurën gjyqësore ose procedurën administrative, largon, zhvendos ose ndërron vendin e shenjave të kufijve administrative, shenjën e tokës ose çfarëdo shenje tjetër që shënjon pronësinë apo pasurinë e paluajtshme ose të drejtën për shfrytëzimin e ujit, ose për të njëjtin qëllim vendos shenja të tilla me qëllim të lajthimit, dënohet me dënimin nga paragrafi 1. i këtij neni.

Neni 414 Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar

1. Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t'i shkaktojë dëm personit

tjetër ose që t'i shkel të drejtat e personit tjetër, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

2. Personi zyrtar që e kryen veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni dhe përfitimi apo dëmi e tejkalon shumë prej pesë mijë (5000) euro, dënohet me gjobë dhe burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.
3. Për qëllime të këtij neni, shpërdorimi i detyrës zyrtare përfshinë, por nuk kufizohet në:
 - 3.1. shkeljen me dashje apo me dijeni të ligjit lidhur me detyrat apo punësimin e zyrtarit;
 - 3.2. moskryerja me dashje e ndonjë detyre të domosdoshme të përcaktuar me ligj;
 - 3.3. pranimi i dhuratës, tarifës apo përparësisë së çfarëdo lloji si rezultat i kryerjes së detyrës zyrtare, përveç nëse pranimi i dhuratës, tarifës apo përparësisë lejohet me ligj;
 - 3.4. keqpërdorimi i pasurisë, shërbimeve apo personelit qeveritar apo i ndonjë sendit tjetër me vlerë që i përket qeverisë e që ka rënë në kujdesin apo posedimin e zyrtarit si rezultat i detyrës apo punës së tij;
 - 3.5. nënshtrimi me dashje i personit tjetër në keqtrajtim ose arrest, ndalim, kontroll, marrje, heqje, vlerësim ose barrë për të cilën e di se është e kundërligjshme; ose
 - 3.6. ndalimi ose pengimi me dashje i tjetrit në ushtrimin apo gëzimin e ndonjë të drejte, privilegji, pushteti apo imuniteti ligjor.

Neni 418 **Përvetësimi në detyrë**

3. Personi zyrtar, i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, përvetëson pasurinë e cila i është besuar për shkak të detyrës apo pozitës së tij, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.
4. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me dobi pasurore apo humbje në vlerë që tejkalon pesë mijë (5.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
5. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me dobi pasurore apo humbje në vlerë që tejkalon pesëdhjetë mijë (50.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.

KODI NR. 04/L-123 I PROCEDURËS PENALE I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 187 **Kushtet e nevojshme për caktimin e paraburgimit**

6. Gjykata mund të caktojë paraburgim ndaj një personi vetëm nëse në mënyrë të qartë ka gjetur se: [...]
 - 1.1. ekziston dyshim i bazuar se personi i tillë ka kryer vepër penale;
 - 1.2. përmbushet njëri nga kushtet e mëposhtme:
 - 1.2.1. kur ai fshihet, kur identiteti i tij nuk mund të vërtetohet ose kur ekzistojnë rrethana të tjera që tregojnë se ekziston rrezik i ikjes së tij;
 - 1.2.2. kur ai fshihet, kur identiteti i tij nuk mund të vërtetohet ose kur ekzistojnë rrethana të tjera që tregojnë se ekziston rrezik i ikjes së tij;
 - 1.2.3. kur pesha e veprës penale, mënyra ose rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, karakteristikat e tij personale, sjellja e mëparshme, ambienti dhe kushtet

nën të cilat ai jeton ose ndonjë rrethanë tjetër personale tregojnë rrezikun se ai mund ta përsërisë veprën penale, ta përfundojë veprën e tentuar penale ose ta kryejë veprën penale për të cilën është kanosur ta kryej.

[...]

Neni 370
Përmbajtja dhe forma e aktgjykimit me shkrim

[...]

6. Gjykata në arsyetimin e aktgjykimit paraqet arsyet për çdo pikë të aktgjykimit.

[...]

Neni 384
Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale

7. Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet nëse:

[...]

1.12. aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me nenin 370 të këtij Kodi

8. Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet edhe kur gjatë procedurës penale, duke përfshirë edhe procedurën paraprake, gjykata, prokurori i shtetit dhe policia:

2.1. nuk kanë zbatuar ndonjë dispozitë të këtij kodi ose kanë zbatuar gabimisht; ose

[...]

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

34. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të parashikuara më tej me Rregullore të punës.

35. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

36. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik”.

2. Individu mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

37. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, gjegjësisht Aktgjykimin [Pml. nr. 474/2021] e Gjykatës Supreme të Kosovës të 28 dhjetorit 2021, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit, dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

38. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

39. Gjykata fillimisht thekson që rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

40. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që

kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta”.

41. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
42. Gjykata rikujton se rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me kërkesën e Prokurorisë Themelore për caktimin e masës së paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës për shkak të dyshimit të bazuar se i njëjti kishte kryer veprat penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “Përvetësimi në detyrë” dhe “Manipulimi me prova” të përcaktuara me dispozitat e KPRK-së. Si rezultat i kësaj kërkesë, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [PIP. nr. 236/21] të 5 nëntorit 2021 ndaj parashtruesit të kërkesës kishte caktuar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej një muaji, të cilën masë më 2 dhjetor 2021 e kishte vazhduar edhe për një muaj tjetër. Si rezultat i ankesës së tij kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore, të 2 dhjetorit 2021, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, të cilën kjo e fundit e kishte refuzuar si të pabazuar. Përmes Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesit të kërkesës i ishte vazhduar masa e paraburgimit vetëm për shkak të rrezikut të ndikimit në dëshmitarë. Si rezultat i kësaj, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, e cila kërkesën e tij kishte refuzuar si të pabazuar, duke vërtetuar qëndrimin dhe konstatimin e dhënë përmes Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Bazuar në shkrësat e lëndës nuk mund të vërehet nëse ndaj parashtruesit të kërkesës nga Prokuroria Themelore është ngritur aktakuzë.
43. Parashtruesi i kërkesës i konteston konstatimet e dhëna përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 474/2021] të Gjykatës Supreme i 28 dhjetorit 2021, në lidhje me Aktvendimin [Kr. 1. nr. 1457/2021] e Gjykatës së Apelit të 14 dhjetorit 2021, dhe Aktvendimin [PIP. nr. 236/21] e Gjykatës Themelore të 2 dhjetorit 2021, duke pretenduar se të njëjtat janë nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me nenet 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 5 të KEDNJ-së, si dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
44. Në vijim të kësaj, Gjykata do të vazhdojë me shqyrtimin dhe vlerësimin e pretendimit të parashtruesit të kërkesës përkitazi me nenin 29 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 5 të KEDNJ-së.

I. Përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 29 të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 të KEDNJ-së

45. Gjykata fillimisht rikujton se parashtruesi i kërkesës thekson se Aktgjykimi [Pml. nr. 474/2021] i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të dispozitave esenciale të KPRK-së, dhe për pasojë ka shkelur të drejtën e tij për liri dhe siguri, të garantuar me nenin 29 të Kushtetutës. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës shton se secili e ka të garantuar të drejtën e lirisë dhe sigurisë dhe se neni 5 i KEDNJ-së garanton mbrojtjen e lirisë fizike, veçanërisht nga “arrestimi apo paraburgimi arbitrar”.

46. Gjykata fillimisht thekson se të drejtat dhe standardet që duhet garantuar në rastin e privimit nga liria janë interpretuar gjerësisht nga GJEDNJ përmes praktikës së saj gjyqësore. Prandaj, përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 5 të KEDNJ-së, Gjykata i referohet parimeve dhe standardeve të përcaktuara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, të afirmuar edhe përmes praktikës së vet Gjykatës që kanë të bëjnë me caktimin e paraburgimit.

i. Parimet e përgjithshme dhe kriteret lidhur me caktimin e paraburgimit

47. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton që për të qenë në përputhje me Kushtetutën dhe KEDNJ-në, arrestimi ose heqja e lirisë duhet të bazohet në një nga arsyet për heqjen e lirisë të parapara në nenin 29, paragrafin 1, të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 të KEDNJ-së.
48. Gjykata rikujton nenin 29, paragrafin 1, pika 2, të Kushtetutës si dhe nenin 5, paragrafin 1, pika c) të KEDNJ-së që përcaktojnë si në vijim:

Neni 29
[E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë]

“1. Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente, si në vijim:

(2) për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një veprë tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjyqimit në mënyrën e përcaktuar me ligj;

[...].”

Neni 5
(E Drejta për Liri dhe Siguri)

1. *Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj:*

[...]

c. kur është arrestuar dhe paraburgosur për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent, kur ka arsye të besueshme për të dyshuar se ai ka kryer një vepër penale ose kur ka motive të arsyeshme për të besuar se është e nevojshme që të pengohet të kryejë një vepër penale ose të largohet pas kryerjes së saj;

[...]

49. Gjykata thekson se në bazë të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në interpretimin e të drejtës së lirisë dhe sigurisë duhet të merren parasysh “parimi i ligjshmërisë” dhe parimi i “mbrojtjes nga arbitrariteti”. Në këtë aspekt, Gjykata rithekson praktikën e GJEDNJ-së, që ka sqaruar se “parimi i ligjshmërisë” në kuptimin e nenit 5 të KEDNJ-së përmban

ndjekjen e procedurës së përcaktuar në ligj (shih, rastet e GJEDNJ-së *Del Rio Prada kundër Spanjës*, nr. 15/1997/799/1002, Aktgjykim i 9 korrikut 2014, paragrafi 125; dhe *Ladent kundër Polonisë*, nr. 11036/03, Aktgjykim i 22 marsit 1995, paragrafi 47). “Parimi i ligjshmërisë” në kuptimin e nenit 5 të KEDNJ-së, nënkupton edhe mungesën apo mbrojtjen nga arbitrariteti. Në vijim, Gjykata rikujton se neni 5 (1) i KEDNJ-së në lidhje me paragrafin 1 tënenit 29 të Kushtetutës kërkojnë, për më tepër, që çdo heqje e lirisë duhet të respektoj qëllimin e mbrojtjes nga arbitrariteti. (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Ladent kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 48).

50. Në praktikën e saj gjyqësore, GJEDNJ ka përcaktuar tri kritere themelore që duhet shqyrtuar për të vlerësuar nëse privimi i lirisë, është i ligjshëm dhe jo arbitrar (shih rastet e GJEDNJ-së, *Merabishvili kundër Gjeorgjisë*, nr. 72508/13, Aktgjykim i 28 nëntorit 2017, paragrafët 183-186; dhe *Labita kundër Italisë*, nr. 26772/95, Aktgjykim i 6 prillit 2000, paragrafi 155), të cilat kritere janë afirmuar edhe përmes praktikës gjyqësore të vet Gjykatës.
 - i. Së pari, duhet të ekzistoj “*dyshimi i bazuar*” që një person i privuar nga liria ka kryer një vepër penale (shih rastin e GJEDNJ-së, *Merabishvili kundër Gjeorgjisë*, cituar më lart, paragrafi 184; dhe rastin e Gjykatës KI63/17, parashtrues *Lutfi Dervishi*, Aktvendim për Papranueshmëri i 16 nëntorit 2017, paragrafi 57).
 - ii. Së dyti, qëllimi i privimit të lirisë “*është që në parim duhet të jetë në funksion të zbatimit të procedurës penale*” (shih, rastet e Gjykatës KI10/18, parashtrues *Fahri Deçani*, Aktgjykim i 21 tetorit 2019, paragrafi 68; KI73/20, parashtrues *Esat Bajrami*, Aktvendim për Papranueshmëri i 5 nëntorit 2020, paragrafi 41; KI63/17, cituar më lart, paragrafi 57, shih po ashtu rastin e GJEDNJ-së, *Ostendorf kundër Gjermanisë*, nr. 15598/08, Aktgjykimi i 7 marsit 2013, paragrafi 68) dhe që për më tepër, duhet të jetë proporcional, në kuptimin që duhet të jetë i nevojshëm “për të siguruar paraqitjen e personit të afektuar para autoriteteve kompetente përkatëse” (shih rastin e Gjykatës KI63/17, parashtrues *Lutfi Dervishi*, cituar më lart, paragrafi 57, shih po ashtu rastin e GJEDNJ-së *Merabishvili kundër Gjeorgjisë*, cituar më lart, paragrafi 185); dhe
 - iii. Së treti, privimi i lirisë apo caktimi i paraburgimit duhet të jetë bërë duke ndjekur procedurën e përcaktuar me ligj (shih rastin e GJEDNJ-së *Merabishvili kundër Gjeorgjisë*, cituar më lart, paragrafi 186).
51. Për më tepër, GJEDNJ në praktikën e saj gjyqësore ka përcaktuar katër arsye themelore të rëndësishme për vazhdimin e paraburgimit, përkatësisht: i) rrezikun e arratisjes; ii) ndërhyrjen në gjykatë; iii) kryerjen e veprave të reja penale; dhe iv) nevojën për të ruajtur rendin publik (shih rastet e GJEDNJ-së, *Tiron kundër Rumanisë*, nr. 17689/03, Aktgjykim, i 7 prillit 2009, paragrafi 37; *Smirnova kundër Rusisë*, nr. 46133/99, Aktgjykim, i 24 korrikut 2003, paragrafi 59; dhe *Piruzyan kundër Armenisë*, nr. 33376/07, Aktgjykim, i 26 shtatorit 2012, paragrafi 94).

ii. Aplikimi i parimeve dhe kritereve të lartcekura në rastin e parashtruesit të kërkesës

52. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht rikujton se për të qenë në përputhje me Kushtetutën dhe KEDNJ-në, arrestimi ose paraburgimi, duhet të ketë mbështetje në njërën nga bazat për privimin e lirisë të specifikuar me nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 5 të KEDNJ-së, respektivisht që arrestimi apo paraburgimi të jetë bërë duke ndjekur procedurën e përcaktuar në ligj, duke përmbushur kushtin e "parimit

të ligjshmërisë" dhe "mbrojtjes nga arbitrariteti"; dhe në fund, në bazë të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, duhet që vepra të jetë e kualifikuar si penale, duhet të ekzistoj qëllimi i arrestit ose privimit të lirisë, dhe duhet të ekzistoj "dyshimi i bazuar" (shih rastin e Gjykatës KI63/17, cituar më lart, paragrafi 60).

53. Gjykata fillimisht konstaton se paraburgimi është bërë në përputhje me procedurën e përcaktuar përmes Kodit të Procedurës Penale, për shkak të dyshimit të bazuar se parashtruesi i kërkesës i ka kryer veprat penale "*Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar*", "*Përvetësimi në detyrë*", dhe "*Manipulimi me prova*", të përcaktuara me dispozita të KPRK-së, përkatësisht caktimi i paraburgimit ndaj tij është bërë përmes Aktvendimit të Gjykatës Themelore, si rezultat i kërkesës së Prokurorisë Themelore. Duke u bazuar në atë që u theksua më lart, Gjykata vëren që caktimi i paraburgimit në rastin e parashtruesit të kërkesës, është i bazuar në nenin 29, paragrafi 1, pika 2 të Kushtetutës në lidhje me nenin 5, paragrafi 1, pika c) të KEDNJ-së.
54. Gjykata tutje vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 29 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 5 të KEDNJ-së pasi që sipas tij Aktvendimi [Kr. 1. nr.1457/2021] i Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimi [Pml. nr. 474/2021] i Gjykatës Supreme janë të përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës penale, duke arsyetuar se dispozitivi dhe arsyetimi i Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, për sa i përket plotësimit të kushteve ligjore për vazhdim të paraburgimit, janë në kundërshtim me njëri-tjetrin.
55. Gjykata ka pohuar vazhdimisht se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se ajo nuk mund të vlerësojë vetë faktet të cilat e kanë bërë një gjykatë të rregullt të marrë një vendim, e jo një tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "shkallës së katërt", që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28; dhe shih, rastet e Gjykatës KI49/19, parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport S.H.A., "Adem Jashari"*, Aktvendim i 31 tetorit 2019, paragrafi 48; dhe KI154/17 dhe KI05/18, parashtrues *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BARBAS"*, Aktvendim për papranueshmëri i 22 korrikut 2019, paragrafi 61).
56. Gjykata Kushtetuese mund të bëjë vlerësimin e interpretimeve ligjore të gjykatave të rregullta përjashtimisht dhe atë vetëm nëse ato interpretime mund të kenë rezultuar në konkluzione arbitrare ose qartazi të paarsyeshme (shih rastin e Gjykatës KI75/17, parashtrues X, Aktvendim për papranueshmëri i 6 dhjetorit 2017, paragrafi 59).
57. Në rastin konkret, Gjykata fillimisht thekson se neni 187 i KPPRK-së përcakton procedurën dhe kriteret ligjore për caktimin e masës së paraburgimit, përfshirë: i) ekzistimin e "dyshimit të bazuar"; ii) përmbushjen e kushteve për vazhdimin e paraburgimit që duke marrë për bazë rrethanat e kryerjes së veprës penale ekziston rreziku që parashtruesi i kërkesës mund të përsërisë veprën penale; si dhe iii) masat më të buta për sigurimin e pranisë së të pandehurit janë të pamjaftueshme për të siguruar praninë e personit të tillë, të parandalojë përsëritjen e veprës penale dhe të sigurojë zbatimin e suksesshëm të procedurës penale (shih, rastin e Gjykatës KI63/17, cituar më lart, paragrafi 68).
58. Gjykata rikujton se në rastin konkret, Gjykata Themelore, duke iu referuar nenit 187 të KPPRK-së, konstatoi se përveç që ekziston dyshimi i bazuar për kryerjen e veprës penale,

po ashtu konstatoi se kishte bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit për arsyet si në vijim: i) pranimin e fajësisë për kryerjen e veprave penale nga parashtruesi i kërkesës gjatë marrjes në pyetje; ii) deklaratat e dëshmitarëve për sa i përket nxjerrjes së gjësendeve prej dhomës së dëshmitarëve nga ana e parashtruesit të kërkesës; iii) rrezikun për t'u arratisur marrë parasysh largimin e mëhershëm të parashtruesit të kërkesës në Bosnjë dhe Hercegovinë; iv) rrezikun e ndikimit në dëshmitarë; v) rrezikun e përsëritjes së veprës penale; dhe vi) vlerësimin se masat tjera alternative ishin të pamjaftueshme në këtë fazë të procedurës duke marrë parasysh elaborimet e lartcekura.

59. Aktvendimi i lartcekur i Gjykatës Themelore u vërtetua nga Gjykata e Apelit, ku kjo e fundit kishte konstatuar se masa e paraburgimit kundër parashtruesit të kërkesës vazhdohej si rezultat i rrezikut të ndikimit në dëshmitarë, përcaktuar me paragrafin 1, nënparagrafët 1.1 dhe 1.2, pika 1.2.2 të nenit 187 të KPPRK-së. Ndërkaq, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk ekzistonte rreziku i arratisjes, sepse ai vullnetarisht i ishte dorëzuar autoriteteve kompetente dhe se nuk kishte rrezik për përsëritje të veprës penale, pasi ai nuk ushtronte më detyrat e punës që kishte pasur kur kishte kryer veprat penale për të cilat ai dyshohej.
60. Në këtë drejtim, Gjykata gjithashtu sjell në vëmendje Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, përmes të cilit pretendimi i parashtruesit të kërkesës për mos-përputhje ndërmjet dispozitivit dhe arsytimit të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit ishte refuzuar si i pabazuar. Në kuptim të kësaj të fundit, Gjykata Supreme konstatoi se Gjykata e Apelit përmes aktvendimit të saj ankesën e parashtruesit të kërkesës e kishte refuzuar si të pabazuar dhe sipas saj masa e paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës ishte vazhduar në pajtim me dispozitat përkatëse të KPPRK-së, gjegjësisht nenit 187 të tij.
61. Bazuar në si më sipër, Gjykata vëren se të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës të ngritura në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë ishin adresuar përmes Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme.
62. Gjykata thekson, që vendimet e gjykatave të rregullta përmbajnë arsyetimet e nevojshme për të gjitha kriteret e lartpërmendura, e relevante për rastin në fjalë. Gjykata rikujton se gjykatat e rregullta, përkatësisht Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, respektivisht kishin arsyetuar se (i) ekziston dyshimi i bazuar dhe (ii) ekziston rreziku i ndikimit të parashtruesit të kërkesës në dëshmitarë.
63. Në fund, Gjykata gjithashtu rikujton edhe kriteret e përcaktuara nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-se, sa i përket privimit të lirisë, të bërë mbi bazën e nenit 29, paragrafit 1, pikës 2 të Kushtetutës në lidhje me nenin 5, paragrafin 1, pikën c) të KEDNJ-së, "kualifikimin e veprës si penale", "qëllimin e privimit", dhe "dyshimin e bazuar". Gjykata rithekson se veprat për të cilat akuzohet parashtruesi i kërkesës janë të kualifikuara si penale në KPRK; që privimi nga liria në rastin e fjalë është bërë për qëllime të administrimit të drejtësisë penale; dhe ashtu siç është elaboruar më lart, ekziston dyshimi i bazuar për kryerjen e veprave të lartcekura penale (shih rastin e Gjykatës KI63/17, të cituar më lart, paragrafi 72).
64. Prandaj, duke marrë për bazë atë që është cekur më lart, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk mbështet mjaftueshëm dhe as nuk argumenton para Gjykatës, se si këto interpretime të dispozitave përkatëse ligjore, të bëra nga Gjykata Supreme dhe gjykatat e rregullta, kanë rezultuar në konkluzione arbitrare ose qartazi të paarsyeshme në

rastin e tij apo se si procedurat para gjykatave të rregullta, në tërësinë e tyre, mund të mos kenë qenë të drejta apo edhe të kenë qenë arbitrare.

65. Rrjedhimisht, Gjykata arrin në përfundim se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 të KEDNJ-së, si rezultat i shkeljes së dispozitave të procedurës penale, bie në kategorinë e pretendimeve që kualifikohen si pretendime të *“shkallës së katërt”* dhe si i tillë është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese ashtu siç është përcaktuar me paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

II. Përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës

66. Në lidhje me pretendimin e tij për shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, Gjykata vëren se thelbi i këtij pretendimi lidhet me argumentin e tij se vendimet e Gjykatës Supreme dhe Gjykatës së Apelit ishin përcjellë me shkelje të dispozitave të procedurës penale, që ndërlidhen me caktimin e masës së paraburgimit. Tutje, Gjykata nënvizon se parashtruesi i kërkesës vetëm i është referuar nenit 31, paragrafit 1 të Kushtetutës, pa shtjelluar specifikisht se si ka ardhur deri te shkelja e të drejtave të tij të përcaktuara me këtë dispozitë kushtetuese. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës shton se: *“Në ndërkohë nga ana e prokurorisë përkatësisht Gjykatës Themelore në Mitrovicë, i pandehuri përkatësisht mbrojtësi i tij nuk janë ftuar e as nuk janë informuar për paraqitjen apo mbledhjen e provave të reja”*.
67. Gjykata vëren se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] ndërlidhet me pretendimin e tij për shkelje të nenit 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës, përkitazi me vendimet e kontestuara, për të cilat Gjykata vlerësoi se i plotësojnë kriteret e parapara për të drejtën për liri dhe siguri.
68. Më tej, Gjykata vëren se praktika e GJEDNJ-së ka sqaruar se neni 5, paragrafi 4 i Konventës, përmban garanci specifike procedurale sa i përket kufizimit të lirisë që janë të ndara nga garancitë procedurale të nenit 6 të Konventës, sa i përket të drejtës për gjykim të drejtë. Për këtë arsye, neni 5, paragrafi 4 i Konventës është *lex specialis* në raport me nenin 6 të Konventës. Rrjedhimisht, Gjykata nuk do t'i shqyrtoj ndaras shkeljet e pretenduara në lidhje me nenin 31 të Kushtetutës (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 15 nëntorit 2005 *Reinprecht kundër Austrisë*, nr. 67175/01, paragrafi 55; dhe rastin e Gjykatës KI63/17, cituar më lart, paragrafi 77).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 8 qershor 2022, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bajram Llatifi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani